



**VENDIM**

**Nr. 80, Datë 09.06.2016**

**MBI**

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SH.A NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HEC “BANJE” ME FUQI TË INSTALUAR 73,000 KW DHE  
“MOGLICË” ME FUQI TË INSTALUAR 182, 500 KW DHE FUQI  
TOTALE TË INSTALUAR 255,500 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 13 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.06.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec “Banjë” me fuqi të instaluar 73,000 KW dhe “Moglicë” me fuqi të instaluar 182,500 KW me fuqi totale të instaluar 255,500 KW,

**Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “Devoll Hydropower” sh.a, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërma a, b, c dhe d) është plotësuar në mënyrë korrekte. Shoqëria është në proces apelimi të masës gjore të vendosur nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve.

- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “Devoll Hydropower” sh.a., ne aktivitetin e prodhimit te energjisë elektrike nga Hec “Banjë” me fuqi të instaluar 73,000 KW dhe “Moglicë” me fuqi të instaluar 182,500 KW dhe fuqi totale të instaluar 255,500 KW për një afat 30 - vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**